



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT  
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr.016-126211, të dt. 06.11.2014 me ndryshime dhe plotësime në Statut 01.nr.016-28448 të dt. 22.03.2018, Kryetari i Komunës në cilësinë e organit më të lartë administrativ dhe punëdhënës nxjerr:

V E N D I M

1. Me këtë vendim, nëpunësi civil **Hazir Mustafa**, i caktuar në detyra punuese: Zyrtar për emergjenca në kuadër të DMSH, **Autorizohet** që t'i kryej detyrat punuese të Drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim nga data 15.05.2023 deri më 26.05.2023 deri sa Drejtori të kthehet nga pushimi vjetor.
2. Nëpunësi civil, i autorizuari, do t'i ushtroj të drejtat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të DMSH në pajtim me dispozitat ligjore.
3. Me rikthimin e Drejtorit të DMSH nga pushimi vjetor, i autorizuari kthehet në detyrat e mëparme punuese të para autorizimit.
4. Gjatë periudhës së autorizimit, i autorizuari ruan të drejtën e pagesës së diferencës në pagë nëse ekziston në mes të pozitës punuese në të cilën është caktuar dhe asaj të cilën e ushtron përkohësisht.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
6. Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit.

**Vendimi t'i dorëzohet:**

- Hazir Mustafa
- Njësisë së personelit

Kryetari i Komunës  
Alban Hyseni